

Titulli i lëndës: Buxheti dhe analiza e shpenzimeve

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike		
Titulli i lëndës:	Buxheti dhe analiza e shpenzimeve		
Niveli:	Bachelor		
Statusi i lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	II		
Numri i orëve në javë:	2+0+2		
Kreditë ECTS:	5		
Koha / Vendi:	FIEK		
Mësimdhënësi:	Nora Sadiku-Dushi		
Të dhënat kontaktuese:	nora.sadiku@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë u ofron studentëve njohuri themelore mbi menaxhimin financiar, kontabilitetin e kostos dhe buxhetimin. Studentët do të mësojnë të analizojnë pasqyrat financiare, të interpretojnë raportet financiare dhe të planifikojnë financat e një kompanie. Gjithashtu, do të zhvillojnë aftësi në vlerësimin e investimeve, menaxhimin e riskut dhe përcaktimin e burimeve të financimit.		
Qëllimet e lëndës:	Të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi themelore në menaxhimin financiar, duke i mundësuar atyre të analizojnë pasqyrat financiare, të planifikojnë financat e kompanisë dhe të marrin vendime efektive financiare për qëndrueshmëri dhe rritje të biznesit.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Me përfundimin me sukses të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Njohin konceptin e financave dhe menaxhimit Financiar në një biznes (Kompani); 2. Identifikojnë hapat e ndërmarrë për parashikimin financiar të një kompanie; 3. Analizojnë deklaratën financiare përmes raporteve financiare, për të bërë krahasime në kohë, ose midis kompanive; 4. Llogarisin pikën e thyerjes së një kompanie prodhuese; 5. Analizojnë variancën e buxhetit të një qendre kostoje. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin			5

Puna në terren			
Testi, punimi seminarik			15
Detyrë shtëpie			
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			25
Përgatitja për provimin final			10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			4
Projektet, prezantimet, etj.			6
Total			125

Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, detyra individuale, projekt grupor
Metodat e vlerësimit:	Vijimi (10%), Detyra individuale (15%) Projekti Grupor (15%) Provimi final (60%)
Literatura primare:	Materiale të përgatitura nga ligjeruesi Dr. Isa Mustafa: Financial Management, RIINVEST, Prishtinë 2008 Dr.Halit Xhafa & Beshir Ciceri: Drejtimi financiar, Tiranë 2016;
Literatura shtesë:	Eugene F. Brigham, Joel F. Houston- Fundamentals of Financial Management, 2021

Java	Titulli i ligjëratisë
<i>Java 1:</i>	Prezentimi i Sillabusit dhe njohje me lenden
<i>Java 2:</i>	Qellimi dhe detyrat e financave
<i>Java 3:</i>	Marrja e vendimeve financiare ne kompani
<i>Java 4:</i>	Vlera ne kohe e parase
<i>Java 5:</i>	Pasqyrat financiare
<i>Java 6:</i>	Raportet financiare
<i>Java 7:</i>	Planifikimi Financiar
<i>Java 8:</i>	Kolokviumi 1
<i>Java 9:</i>	Investimet
<i>Java 10:</i>	Risku dhe menaxhimi i riskut
<i>Java 11:</i>	Burimet afteshkurtera dhe afatmesme te financimit
<i>Java 12:</i>	Burimet afategjata te financimit
<i>Java 13:</i>	Kostoja e kapitalit
<i>Java 14:</i>	Menaxhimi operativ financiar
<i>Java 15:</i>	Kolokviumi 2

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.